



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 254/1 prot.

Tiranë më 20. 2.2019

Lënda: Kthim përgjigje lidhur me kërkesën për dhënie mendimi.

UNIVERSITETIT TË TIRANËS

FAKULTETI I DREJTËSISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u njoh me kërkesën tuaj, nr. 254 Prot, datë 13.02.2019, nëpërmjet të cilës kërkohet dhënie mendimi në lidhje me faktin nëse të dhënat e studentëve që mblidhen dhe administrohen nga Fakulteti i Drejtësisë përbëjnë të dhëna personale në kuptim të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Ju bëjmë me dije se me të dhëna personale, sipas parashikimit të pikës 1, të nenit 3, të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar do të kuptojmë:

"Të dhëna personale" është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social".

Sa më sipër, të dhënat që përmban dosja e një studenti dhe të dhënat mbi listprezencën e një studenti, në kuptim të Ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, konsiderohen të dhëna personale për sa kohë e identifikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose e bëjnë të identifikueshëm studentin. Në këtë kuadër aksesimi dhe përpunimi i këtyre të dhënave duhet të bëhet në përputhje me parimet, kriteret dhe detyrimet e Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se aksesimi dhe përpunimi i këtyre të dhënave legjitimohet nëse përmbushet njëri nga kriteret ligjore të parashikuara në nenin 6, të Ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Në vijim, mbetet në vlerësimin e kontrolluesit "Fakulteti i Drejtësisë" përmbushja e këtyre kriterëve, që është objekt edhe i kontrollit nga Zyra e Komisionerit.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

